



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prunijeno Mirënjana 02-08-2021

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shënimet Prilog	Vlera Vrednost
	01-110/05-533		



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, dhe nenit 36 paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën: 30.07.2021, merr këtë:

## V E N D I M

### Për shpalljen në diskutim publik propozim rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2022

#### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë MIRATON vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2022.

#### Neni 2

Propozimi në diskutim publik i Propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2020, do të jepet në diskutim publik deri më 02.09.2021. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik. Gjithashtu në formën të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së dëgjimit publik në Zyrën e Drejtorisë së Financave të Komunal të Vitisë, ndërtesa e komunës, zyra nr. 31 si dhe në forme elektronike mund të dërgohen në emalin adresën [shefki.aliu@rks-gov.net](mailto:shefki.aliu@rks-gov.net). Dokumenti gjendet në wep faqen e Komunës së Vitisë, [kk.rks-gov.net/viti](http://kk.rks-gov.net/viti).

#### Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën 07.09.2021, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

#### Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

#### Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive në Propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2022.

#### Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në web faqen e komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit,
2. MAPL-së, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI

Naim Pira

